



Komuna e Klinës

Kryetari i komunës

01Nr. 710-18050 /2023

Klinë, date 21.10 /2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 22 dhe 28 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, nr.08/L-196, si dhe dispozitat e nenit 91 të Statutit të komunës e Klinës të vitit 2010, më qellim të përmbushjes së obligimeve zyrtare, kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Per autorizimin e zyrtareve përgjegjës për menaxhimin dhe përfaqësimin e lendeve gjyqësore

- AUTORIZOHEN**, zyrtaret e poshtëshënuar, si përgjegjës për menaxhimin dhe përfaqësimin e lendeve gjyqësore pranë gjykatave kompetente, dhe atë si në vijim:
 - Driton Raci**, menaxhimin e lendeve dhe përfaqësimin e tyre pran gjykatave kompetente të lendeve kontesimore- pronësorë dhe të administratës komunale;
 - Elbarim Morina**, përfaqësimin e lendeve të arsimit pran gjykatave kompetente, si dhe;
 - Driton Berisha**, përfaqësimin e lendeve të shëndetësisë pran gjykatave kompetente.
- Te përmendurit ngarkohen më pune shtese vëllim të punëve për një periudhe të pacaktuar deri në shfuqizimin e këtij vendimi të cilët përfaqësojnë komunën e Klinës dhe mbrojnë interesat e saj pranë gjykatave kompetente në vend.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë ne fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- Zyra e Kryetarit;
- Zyra e personelit;
- DKA;
- DSHMS
- Drejtoria e Financave, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari
Zenun ELEZAJ